

VENDIM

Nr.114, datë 27.1.2009

PËR MARRJEN E MASAVE EMERGJENTE, PËR PËRMIRËSIMIN E SITUATËS SË SIGURISË DHE TË VEPRIMTARIVE NË INSTALIMET E IMPIANTET, QË SHËRBEJNË PËR DEPOZITIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE

Në mbështetje të neneve 59, pika 1 shkronja “d”, e 100, të Kushtetutës, të nenit 2 të ligjit nr.9322, datë 25.11.2004 “Për miratimin e strategjisë së sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë”, të neneve 1, 2 e 4 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e grupit të punës për marrjen e masave emergjente, për përmirësimin e situatës së sigurisë, në impiantet dhe instalimet, që shërbejnë për depozitimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe të nënprodukteve të tyre, i cili të drejtohet, bashkërisht, nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, e ku të bëjnë pjesë zëvendësministrat e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Brendshme, si dhe drejtuesit e Inspektoratit Qendror Teknik (IQT), Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar (INUK), agjencive rajonale të mjedisit (ARM) dhe drejtorive për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin (PMNZSH).
 2. Grupi i punës ka për detyrë të realizojë:
 - a) Kontrollin dhe verifikimin e respektimit të kushteve teknike të ndërtimit dhe funksionimit të të gjitha impianteve e instalimeve, ku kryhet veprimtaria e depozitimit, transportimit dhe tregtimit, me shumicë ose pakicë, të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, për të përcaktuar nivelin e sigurisë.
 - b) Brenda 2 (dy) muajve, listën e subjekteve, që kryejnë veprimtarinë e depozitimit, transportimit dhe tregtimit, me shumicë ose pakicë, të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, pa lejet përkatëse, ose listën e subjekteve, veprimtaria e të cilave paraqet rrezik për sigurinë e pronës, të jetës dhe të mjedisit, sepse ndodhen brenda territorit të zonave të banuara dhe t’ia paraqesë Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
 - c) Listën për subjektet e tjera, jashtë zonave të banuara, që e ushtrojnë veprimtarinë pa lejet përkatëse ose që veprimtaria e tyre paraqet rrezik për sigurinë e pronës, të jetës dhe të mjedisit dhe t’i paraqesë, brenda 3(tre) muajve, Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
- Afatet e përcaktuara në shkronjat “b” e “c” të pikës 1 të këtij vendimi fillojnë 15

(pesëmbëdhjetë) ditë pas hyrjes në fuqi të vendimit.

3. Veprimtaritë e depozitimit, transportimit ose tregtimit, me shumicë ose pakicë, të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, në impiante dhe instalime të ndërtuara në rrugët dhe në mjedise urbane (brenda qyteteve ose zonave të banuara), të cilat zhvillohen edhe pa lejet përkatëse, dhënë sipas legjislacionit në fuqi, dhe paraqesin rrezikshmëri për sigurinë e pronës, të jetës dhe të mjedisit,

sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi, të prishen ose të mbyllen nga Inspektorati Ndërtimor

e Urbanistik i bashkisë/komunës apo nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, në përputhje me ligjin nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, në bashkëpunim dhe me

mbështetjen e Policisë së Shtetit.

4. Veprimtaritë e depozitimit, transportimit ose tregtimit, me shumicë ose pakicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, në impiantet dhe instalimet e ndërtuara jashtë qyteteve ose jashtë zonave të banuara, që zhvillohen pa lejet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, por rezultojnë se plotësojnë kushtet teknike dhe të sigurisë, bllokohen nga IQT-ja, inspektorati ndërtimor e urbanistik

i bashkisë/komunës apo Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Policisë së Shtetit.

Subjekti përkatës, brenda 3 muajve pas realizimit të kontrollit, sipas afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, duhet të bëjë plotësimin e dokumentacionit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

5. Veprimtaritë e depozitimit, transportimit dhe tregtimit, me shumicë ose pakicë, të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, në impiante dhe instalime, të cilat ushtrohen nga subjekte të pajisura me lejet përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi, por që veprimtaria e tyre cilësohet se paraqet rrezikshmëri për sigurinë e pronës, të jetës dhe të mjedisit, sipas përcaktimeve

të pikës 1 të këtij vendimi, të mbyllen ose të prishen nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar dhe Policia e Shtetit.

6. Shpenzimet për mbylljen ose prishjen fizike të impianteve dhe instalimeve, që shërbejnë për kryerjen e veprimtarive të depozitimit, transportimit ose tregtimit, me shumicë ose pakicë, të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, sipas pikave 2, 3 e 4 të këtij vendimi, bëhen me shpenzimet e vetë subjekteve.

7. Ndalohet futja nga importi, në formë skrapit, i bombolave, që shërbejnë për depozitimin, transportimin dhe tregtimin e gazit të lëngshëm të naftës (GLN).

Bombolat, që nuk plotësojnë standardet e sigurisë, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.8739, datë 12.2.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve nën presion”, konfiskohen nga IQT-ja.

8. Vërtetimi për kontrollin e objektit, për respektimin e kushteve teknike, i lëshuar nga IQT-ja, për marrjen e lejeve përkatëse për depozitimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, rinovohet çdo vit.

Tarifa për këtë shërbim përcaktohet me udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrisë së Financave.

9. Ndalohet tregtimi i naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre nga subjekte, që kryejnë veprimtarinë e depozitimit, transportimit ose tregtimit me shumicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, për të gjitha subjektet që kryejnë veprimtari të depozitimit, transportimit ose

tregtimit me pakicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, të cilat nuk janë pajisur me lejet apo

autorizimin përkatës, në përputhje e kërkesat e legjislacionit në fuqi për ushtrimin e këtyre veprimtarive.

10. Në rast të mosrespektimit të kësaj kërkesë, nga subjektet e tregtimit me shumicë, të përmendura më sipër, IQT-ja pezullon të drejtat e lejes së tregtimit dhe i propozon organit përkatës revokimin e lejes.

11. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha